

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fushën e të drejtës për informim

Me miratimin e ligjit nr. 119/2014, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi edhe ndryshimet në ligjin nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar duke shtuar përveç përgjegjësi të parashikuara në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, edhe ushtrimin e kompetencave të mëposhtme në fushën e së drejtës së informimit:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fushën e të drejtës për informim:

a) shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin "Për të drejtën e informimit; b) shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike; c) kryen hetimet e nevojshme administrative gjatë ushtrimit të kompetencave të tij; ç) njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara "sekret shtetëror". Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e "sekretit shtetëror", sipas legjislacionit në fuqi; d) vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit; dh) nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit; e) monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit; ë) kryen sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit; f) bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës; g) me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 27 - Bashkia Kolonjë

Vendim Nr. 28 - Bashkia Këlcyrë

Vendim Nr. 29 - Autoriteti Rrugor Shqiptar

Vendim Nr. 31 - Bashkia Këlcyrë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit qershor, ka dhënë katër vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI) ndër të cilët 3 vendime urdhërimi dhe 1 vendim mospranimi.

Me anë të Vendimit nr. 27, datë 01.06.2021, KDIMDP ka pranuar ankesën për refuzim dhënie informacioni ndaj Bashkisë Kolonjë (Autoriteti Publik) ku kërkohet informacion mbi:

- Pëlqimi paraprak i kryetarit të Bashkisë Kolonjë, lidhur me propozimin e ardhur për mënyrën e menaxhimit të zonës së mbrojtur Bredhi i Hotovës dhe Gërmenj;
- Çdo dokument apo qëndrim që ka mbajtur Autoriteti Publik, lidhur me këtë proces.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, Zyra e Komisionerit, kërkoi qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik në përgjigjen e tij argumentoi mungesën e përgjigjes duke kërkuar sqarim të mëtejshëm për vitin në të cilin është bërë kërkesa për propozim, si dhe duke e drejtuar kërkuesin pranë organit që ka përgatitur VKM, i cili disponon edhe dosjet përkatëse.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerësoi se informacioni - dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit "Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik".

Komisioneri vlerëson se të dhënat që ka paraqitur ankuesi lidhur me informacionin e kërkuar, janë të mjaftueshme për t'a identifikuar këtë informacion nga ana e Autoritetit Publik, në përputhje kjo me gërmën "d" të nenit 11 të LDI.

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Gjithashtu, Autoriteti Publik për vënien në dispozicion të informacionit duhet të mbante në konsideratë parashikimet e pikës 1, të nenit 12 të LDI ku përcaktohet se: "Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuesin në saktësimin e kërkesës".

Për sa i përket argumentit të parashtruar se, "Kërkuesi mund të drejtohet organit që ka përgatitur VKM, i cili disponon edhe dosjet përkatëse", sqarojmë se pika 2, e nenit 12 të LDI përcakton: "Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar".

Për sa më sipër, bazuar në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet qartë se, objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e "prodhuesit" apo "mbajtësit" të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie informacioni të kërkuar në të gjitha pikat e kërkesës.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Konferenca e 12-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC)

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zgjidhet anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës

Në datat 23-24 qershor 2021 u mbajt Sesi i Mbyllur i Konferencës së 12-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners - ICIC).

Me tematikë qendrore “E drejta e informimit për një botë në ndryshim, përdorimi i teknologjisë për të nxitur gjithpërfshirjen” më shumë se 120 përfaqësues nga mbi 60 autoritete kombëtare/rajonale anëtare të Konferencës dhe me statusin e vëzhguesit morën pjesë në dy ditët e këtij aktiviteti të zhvilluar virtualisht.

Në të u paraqit Raporti Vjetor dhe u raportua për zhvillimet më të fundit në fushën e së drejtës për informim nga të gjitha zonat gjeografike të botës, ndërsa u miratuan këto dokumente të rëndësishme:

- Strategjia 2021-2024;
- Manuali i procedurës, që përcakton mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Konferencës, Komitetit Ekzekutiv dhe grupeve të punës;
- Përcaktimi i Komitetit Ekzekutiv si organi që do të zbatojë objektivin e ndryshimit të Kartës së Johannesburgut të 13 marsit 2019;
- Rezoluta “Dhënia në mënyrë proaktive e informacionit në lidhje me Covid-19” (propozuar nga Australia, Zelanda e Re dhe Kanadaja).

Gjithashtu, u shpallën zyrtarisht edhe rezultatet e zgjedhjeve të para për Komitetin Ekzekutiv me mandat 3-vjeçar, në të cilin bën pjesë dhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

ICIC funksiononte deri tani nën drejtimin e një grupi të përkohshëm, i udhëhequr nga Komisioneri i Informimit të Mbretërisë së Bashkuar, i cili ndërmori reformimin e thellë të organizatës sipas kriterëve të Kartës së Johannesburgut.



Raportimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë Konferencës së 12-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)

Pandemia COVID-19 dha ndikimin e saj edhe në përmbushjen e të drejtës së qytetarëve për qasje në informacionin me karakter publik, parashikuar nga ligji për të drejtën e informimit. Zyra e Komisionerit u angazhua në publikimin e posterit "Transparenca në distancë", i cili kishte si qëllim ndërgjegjësimin e autoriteteve publike për të qenë sa më proaktiv edhe në kushtet e pandemisë. Në ndryshim nga praktika ndërkombëtare, ku një numër shtetesh e kufizuan zbatimin e kësaj të drejte, duke e pezulluar me të paktën 30-60 ditë, në vendin tonë nuk pati asnjë vendimmarrje të kësaj natyre.

Situata e krijuar nga pandemia globale e bëri të vështirë organizimin e punës në zhvillimin e proceseve administrative të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit "Për të Drejtën e Informimit" por pavarësisht këtyre vështirësive objektive, Zyra e Komisionerit vijoi rregullisht aktivitetin në trajtimin e ankesave. Një sërë masash të tjera u morën për zhvillimin e trajnimeve - takimeve online dhe publikimin e informacionit në faqen zyrtare.

Që prej muajit korrik të vitit 2020 ka nisur publikimi në faqen zyrtare në internet të newsletter-it elektronik "E drejta për informim". Ky format është një përmbledhje e veprimtarisë mujore të institucionit mbi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe i dërgohet të gjithë koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe të interesuarve.

Gjatë viteve të zbatimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe praktikave të mbledhura nga Zyra e Komisionerit, janë evidentuar disa raste për të cilat legjislacioni aktual nuk ofron zgjidhje. Me rekomandimin e ekspertëve, projektligji për ndryshimin e ligjit për të drejtën e informimit do të jetë pjesë e paketës për harmonizimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë, për arsye se kompetencat e Komisionerit edhe për të drejtën për informim, janë të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndaj këto dy projektligje sugjerohet të kalojnë paketë në të njëjtën kohë.

